



International
Labour
Organization



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Platforma e punësimit dhe çështjeve sociale 2

► **Udhëzime për forcimin e rolit të inspektorëve të punës për trajtimin e punës së padeklaruar**





Të drejtat e autorit[®] Organizata Ndërkombëtare e Punës 2023

Botuar për herë të parë në vitin 2023

Ky dokument u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadrin e Projektit ESAP 2 (Platforma për Punësimin dhe Çështjet Sociale). Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Fotoja e kopertinës: Aleksandarlittlewolf - në Freepik

Platforma e punësimit dhe çështjeve sociale 2¹

► Udhëzime për forcimin e rolit të inspektorëve të punës për trajtimin e punës së padeklaruar

Rekomandimi (Nr. 204)² i ILO-s për Kalimin nga Ekonomia Informale në Ekonominë Formale, i vitit 2015 përcakton rëndësinë e "ekzistencës së sistemit adekuat dhe të përshtatshëm të inspektimit, shtrirjes së mbulimit të inspektimit të punës në të gjitha vendet e punës në ekonominë informale me qëllim mbrojtjen e punëtorëve, dhe ofrimin e orientimit për organet ekzekutive duke përfshirë edhe mënyrën e adresimit të kushteve të punës në ekonominë informale".³ Në këtë këndvështrim, ky dokument bën një përshkrim të shkurtër të rekomandimeve kryesore të përcaktuara nga ILO për përdorimin e një strategjie sa më efektive në fushën e inspektimit të punës për trajtimin e punës së padeklaruar.

► Rekomandimet e ILO-s për qasjet efektive të inspektimit të punës për të trajtuar punën e padeklaruar

Ky seksion është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë prezantohet shkurtimisht kuadri i nevojshëm për qasjen efektive të inspektimit të punës ndaj punës së padeklaruar. Kjo pasohet nga udhëzimet e përgjithshme për forcimin e inspektimit të punës në luftën kundër punës së padeklaruar.

► Kushtet e nevojshme për inspektimin efektiv të punës


1. Inspektimi i punës mban përgjegjësinë kryesore politike dhe operative për trajtimin e punës së padeklaruar. Realizimi efektiv i këtyre funksioneve kërkon personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar, si dhe burime financiare dhe materiale të tjera për të garantuar realizimin me sukses të detyrave të inspektoratit.
2. Qeveritë e ekonomive pjesëmarrëse duhet të kryejnë *vlerësimin dhe diagnostikimin* e duhur të faktorëve, karakteristikave, shkaqeve dhe rrethanave të informalitetit në kontekstin kombëtar për të shërbyer si bazë e punës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe masave të tjera që synojnë të lehtësojnë kalimin drejt ekonomisë formale.⁴

1 Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale (ESAP) 2 financohet nga Bashkimi Evropian.

2 http://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:R204

3 Paragrafi 27 i Rekomandimit nr. 204.


4 Paragrafi 8 i Rekomandimit nr. 204.



3. Politika kombëtare efektive kërkon *angazhimin e fortë të ekonomive pjesëmarrëse për të hartuar dhe zbatuar një kornizë gjithëpërfshirëse politikash* për t'iu kundërvënë punës së padeklaruar. Kjo duhet të përkthehet në një mjedis institucional mundësues që nënkupton përcaktimin e qartë të rolit të autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive, identifikimin e përgjegjësive të organeve përkatëse dhe krijimin e mekanizmave koordinues. Politikat duhet t'i ushqejnë programet kombëtare me rezultate të përcaktuara, afate kohore, përgjegjësi dhe mekanizma monitorimi dhe vlerësimi.
4. *Dialogu social* duhet të konsiderohet si një motor politik ndërsektorial, i integruar në të gjitha strategjitë dhe veprimet e kryera.
5. Ekonomitë pjesëmarrëse duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të përmirësuar kontekstin ekonomik duke krijuar kushtet për konkurrencë të shëndetshme për biznesin, rregullim të shëndoshë të tregut të punës dhe politika për mbrojtjen sociale, të mbështetura dhe të financuara në mënyrën e duhur. Në këtë këndvështrim, ngarkesat administrative për punëdhënësit duhet të reduktohen, aty ku është e mundur, me qëllim përmirësimin e respektimit të së drejtës së punës, përkatësisht duke lehtësuar regjistrimin e punëtorëve, deklarimin tek sigurimet shoqërore dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nëpërmjet procedurave të thjeshta dhe të aksesueshme (dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë afateve kohore tepër të gjata që mund të pengojnë inspektimin). Stimujt për formalizimin duhet të studiohen dhe të propozohen aty ku është e mundur.
6. Për këtë qëllim nevojitet edhe krijimi i *kuadrit ligjor gjithëpërfshirës të punës*, që nënkupton si më poshtë:
 - (i) Përkufizimi i qartë i punës së padeklaruar (qoftë në ligj ose/dhe në nivel administrativ), ku parashikohen të gjitha shprehjet e fenomenit, duke i dalluar nga koncepte të tjera të ndryshme të lidhura me të, si paligjshmëria, informaliteti dhe mashtrimi në aspektin e punës dhe të sigurimeve shoqërore;
 - (ii) Hartimi i legjislacionit të drejtpërdrejtë, që përkthehet në legjislacion që mund të respektohet dhe zbatohet me lehtësi nga autoritetet; dhe ku
 - (iii) Kompetencat e autoriteteve ekzekutive janë të shprehura qartë.

Standardet e përditësuara ndërkombëtare të punës luajnë një rol kyç sa i takon orientimit dhe përcaktimit të elementeve të nevojshme që duhet të merren parasysh nga ekonomitë pjesëmarrëse gjatë hartimit të legjislacionit kombëtar efektiv.

7. Ekzistenca e sistemit efektiv pengues/frenues së bashku me bashkëpunimin e pandërprerë të autoriteteve ekzekutive me gjyqësorin janë të nevojshme, e përforcuar edhe nga orientimet strategjike të mëposhtme:
 - (i) Sanksione efektive dhe bindëse për të penguar punën e padeklaruar. Në këtë aspekt, sanksionet duhet të jenë proporcionale me shkeljen dhe kjo duhet të shoqërohet edhe me procedura të posaçme për t'i zbatuar ato pa vonesa të panevojshme;
 - (ii) Përdorimi i qasjeve novatore si qasje plotësuese për sanksionet tradicionale, të cilat inkurajojnë dhe përmirësojnë respektimin e rregullave dhe që janë të integruara me strategji të tjera për të luftuar punën e padeklaruar;



(iii) Procedurat e sanksioneve dhe mekanizmat e përgjegjesisë duhet të përmirësohen në nivel ekonomie dhe në nivel ndërkufitar për të shmangur mungesën e efektivitetit të sanksioneve.

8. Strategjitë për punën e padeklaruar duhet të përfshijnë një *dimension të fortë ndërgjegjësues*, me fushata që synojnë ndryshimin e kulturës lokale për atë që nuk është e pranueshme në aspektin social, jo vetëm për shkak se është “e ligjshme” apo “e paligjshme”, por edhe për shkak se përbën shkelje të të drejtave themelore në punë. Në strategji duhet të përfshihen si masat parandaluese ashtu edhe ato penguese/ frenuese.

► Udhëzime për forcimin e inspektimit të punës në luftën kundër punës së padeklaruar

► Përcaktimi i strategjive dhe planeve dhe administrimi efektiv i burimeve

9. Hartimi i planeve dhe programeve strategjike për punën e padeklaruar duhet të bëhet në mënyrë periodike duke u konsultuar me autoritetet e tjera përkatëse dhe me partnerët socialë. Planifikimi strategjik përfshin, ndër të tjera, elementët e mëposhtëm:

(i) Përcaktimi i *'treguesve të riskut lidhur me punën e padeklaruar'* është thelbësor për planifikimin e vizitave inspektuese. Kjo përkthehet në një veprimtari shumë më të saktë ekzekutive, duke shmangur përdorimin e burimeve nga inspektorati i punës për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin, dhe duke maksimizuar kështu përpjekjet e tij për identifikimin e njësive ekonomike që nuk respektojnë ligjin dhe për t'i orientuar drejt konformitetit.

(ii) Përcaktimi i *objektivave të qarta dhe qasjeve të përshtatura* për të adresuar shumëllojshmërinë e karakteristikave, rrethanave dhe nevojave të punëtorëve dhe njësive ekonomike të pranishme në ekonominë e padeklaruar.

(iii) Të drejtat e *grupeve vulnerabël* duhet të jenë prioritet. Inspektorët e punës duhet të konsultohen posaçërisht me autoritetet e migracionit për të garantuar mbrojtjen legjitime të të drejtave të punëtorëve migrantë – edhe në rastet e punës së paligjshme.

(iv) Gjatë përcaktimit të *politikës për inspektimin e punës* për identifikimin e punës së padeklaruar, autoriteti qendror duhet të:

a. marrë parasysh nevojën për vendosjen e *ekuilibrit të duhur me fusha të tjera*, si siguria dhe shëndeti në punë;

b. përgatisë plane të bazuara në fakte dhe të dhëna për *sektorët dhe rajonet* ku dihet ose dyshohet mbizotërimi i punës së padeklaruar.

(v) Me qëllim *monitorimin dhe matjen* e ndikimit të planeve vjetore të inspektimit në luftën kundër punës së padeklaruar si dhe rritjen e efektivitetit dhe ndikimit të tyre duhet të përdoren metoda të ndryshme si për shembull metoda e tabelës së rezultateve, ndër të tjera. Kjo do të garantojë arritjen e rezultateve të planifikuara nga veprimet e ndërmarra. Gjithashtu, kjo metodë do të përmirësojë transparencën dhe do të përcaktojë piketat që do të shërbejnë si bazë për planifikimin në të ardhmen.



10. Një parakusht për përcaktimin e strategjive dhe për planifikimin është krijimi i *sistemeve të informacionit të pajisura me burime të mjaftueshme* që ofrojnë të dhëna të besueshme në mënyrë sistematike. Kjo do ta ndihmojë inspektoratin e punës për kryerjen e një analize të thellë me qëllim zbulimin e modeleve, tendencave dhe planifikimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së tij.
11. *Teknologjitë e informacionit* duhet të kenë një përdorim më të gjerë në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe publicitetit. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet kombinimit të bazave të ndryshme të të dhënave, me qëllim zbulimin e shkeljeve në të gjitha nivelet (sigurimet shoqërore, taksat, ligji i punës, siguria dhe shëndeti në punë). Përmirësimi i cilësisë dhe aksesueshmërisë së të dhënave duhet të jetë objektivi kryesor në këtë drejtim. Qeveritë duhet të sigurojnë që niveli i konfidencialitetit të caktuar për këto të dhëna të mos pengojë ndarjen e informacionit ndërmjet agjencive përkatëse qeveritare. Gjithashtu, ai nuk duhet të pengojë as publikimin legjitim të identitetit të ndërmarrjeve që abuzojnë me punën e padeklaruar. Një publicitet i tillë mund të luajë një rol të vlefshëm në aspektin e dekurajimit të praktikave të tilla dhe paralajmërimit të punëtorëve në lidhje me këtë rrezik. Përveç kësaj, është e nevojshme që të shikohet mundësia e përdorimit të mënyrave të reja për shfrytëzimin e të dhënave të mbledhura dhe mediave.
12. Inspektorët që merren me punën e padeklaruar duhet t'i nënshtrohen *trajnimin të duhur në mënyrë të vazhdueshme*. Këto trajnime duhet të fokusohen tek legjislati në fuqi, identifikimi i llojeve të ndryshme të mashtrimeve në aspektin e punës dhe sigurimeve shoqërore, njohja e përgjegjësisë dhe financave dhe rolet plotësuese të institucioneve të tjera që përballen me argumente të ngjashme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimin sensibilizues për të përgatitur inspektorët për t'u marrë me punëtorët e padeklaruar që mund të ndodhen në situata punësimi abuzive dhe të cilëve u mungojnë aftësitë gjuhësore, njohuritë ose përfaqësimi për të mbrojtur interesat e tyre në mënyrë sa më efektive.
13. Duke pasur parasysh kompleksitetin e punës së padeklaruar, *specializimi i grupeve* ka rezultuar të jetë një praktikë e mirë për adresimin e saj. Këto grupe të specializuara shpesh marrin trajnime specifike dhe të zgjeruara për çështjet e punës së padeklaruar dhe kanë në përbërje të tyre anëtarë të agjencive të ndryshme qeveritare për të vepruar në mënyrë të integruar dhe të koordinuar.

► Roli proaktiv i Inspektoratit të Punës


14. Inspektorët e punës duhet të përdorin *qasje proaktive* për trajtimin e punës së padeklaruar duke u përpjekur për të siguruar kalimin e qëndrueshëm në ekonominë formale. Për këtë qëllim, duhet shmangur mendjengushtësia dhe të shfrytëzohen plotësisht të gjitha kompetencat dhe prerogativat e inspektimit në mënyrë që të arrihet konformiteti dhe respektimi i ligjit, duke nxitur edhe veprimin e të gjithë aktorëve që mund të ndikojnë për arritjen e këtij konformiteti.
15. Vizitat inspektuese duhet të marrin në konsideratë *të gjitha aspektet që lidhen me punën e padeklaruar* dhe jo vetëm statusin e padeklaruar të punëtorit. Për shembull, kur zbulohet një rast i punës së padeklaruar, inspektorët duhet të sigurohen që punonjësi të marrë çdo përfitim që i takon (dhe çdo pagë të papaguar). Inspektorët duhet, gjithashtu, të kontrollojnë kushtet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës dhe të marrin masa në rastet e mosrespektimit të ligjit (vënia e gjobave ose raportimi/kallëzimi në prokurori ose tek institucioni përgjegjës).

16. Edhe *programet edukative dhe këshillimore* për partnerët socialë dhe publikun në përgjithësi duhet të konsiderohen si pjesë e reagimit të përgjithshëm të inspektorateve të punës ndaj punës së padeklaruar dhe si një komponent i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe parandaluese. Fushatat e posaçme ose aktivitetet e synuara mund të kontribuojnë në përpjekjet e përgjithshme kundër këtij fenomeni dhe përdorimi i projekteve pilot ose fushatave mund të ndihmojë për testimin e qasjeve novatore ose ideve të reja. Meqenëse puna e padeklaruar është një sfidë e kahershme dhe e rrënjosur thellë, aktivitete të tilla duhet të ndërmerren në kuadrin e një strategjie ose programi të përgjithshëm për punën e padeklaruar. Në këtë aspekt, rekomandohet fort që çdo strategji të përdorë një kombinim të qasjeve ndaj punës së padeklaruar, ku përfshihen informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit, parandalimi dhe frenimi (sanksionet).

► Bashkëpunimi

17. Kriteret e qarta të *veprimit bashkëpunues ndërmjet autoriteteve të ndryshme ekzekutive* duhet të nxiten nëpërmjet legjislacionit, marrëveshjeve të bashkëpunimit (Memorandum Mirëkuptimi) dhe strategjive. Qeveritë duhet të përmirësojnë dhe konsolidojnë rrjetet ndërqeveritare, nëpërmjet sigurimit të kontekstit politik dhe ligjor në mënyrë që të mund të krijohen forma efektive të bashkëpunimit.
18. *Shkëmbimi i të dhënave* përmirëson efikasitetin dhe inkurajon bashkëpunimin, pasi iu ofron institucioneve të ndryshme qeveritare një tablo më të mirë të përgjithshme në lidhje me punën e padeklaruar dhe aftësi më të mirë për të përshtatur reagimin e tyre.
19. Nevojitet zhvillimi i *aksioneve të përbashkëta të inspektimit* ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, sigurimet shoqërore, taksat dhe migracionin për të mundësuar qasjen holistike ndaj aspekteve që lidhen me punësimin e padeklaruar dhe për të siguruar mbulimin e të gjitha aspekteve të kushteve të punës. Kjo praktikë forcon koordinimin dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet organeve të ndryshme inspektuese.
20. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet bashkëpunimit me *partnerët socialë* në të gjitha nivelet. Bashkëpunimi ndërmjet qeverive, punëtorëve dhe punëdhënësve duhet të inkurajohet në të gjitha nivelet e sistemit të marrëdhënieve industriale. Organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve duhet të angazhohen rregullisht me autoritetet e inspektimit të punës, si pjesë e aktiviteteve të tyre për punën e padeklaruar drejt dekurajimit të të ashtuquajturit *dumping* social dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor në kontekstin lokal. Përpjekje duhet të bëhen edhe për të nxitur bashkëpunimin midis vetë punëtorëve të padeklaruar dhe autoriteteve inspektuese (p.sh. një periudhë e garantuar qëndrimi për punëtorët migrantë pa dokumente që i kallëzojnë rastet e punës së padeklaruar tek inspektorët).
21. I vetëm, aksioni kundër punës së padeklaruar në nivel ekonomie nuk është i mjaftueshëm, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën e saj shpesh ndërkufitare (p.sh. krahu migrant i punës, punëtorët e dërguar përkohësisht në një vend tjetër për të punuar). Për këtë qëllim,

nevojitet edhe marrja e masave plotësuese në *nivel ndërkombëtar dhe rajonal* si: shkëmbimi i njohurive përmes bazave të të dhënave me akses të përbashkët, regjistrave të përbashkët, inspektimeve të përbashkëta ndërmjet inspektorateve (veçanërisht pranë zonave kufitare) dhe aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe transferimeve të përkohshme në vende pune/ organizata të tjera, të cilat duhet të konsiderohen si një mënyrë për të ndërtuar rrjetet profesionale ndërmjet inspektorateve dhe për të përmirësuar njohjen e sistemeve të ndryshme të inspektimit. Përveç kësaj, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe zhvillimit të një sistemi të koordinuar sanksionesh në nivel rajonal, veçanërisht në lidhje me zbatimin ndërkufitar.



▶ Shtojca I


▶ Hapat për planifikimin e fushatës së inspektimit kundër punës së padeklaruar

Në mënyrë skematike, planifikimi i fushatës për të luftuar punën e padeklaruar në nivel ekonomie duhet të përfshijë hapat e mëposhtëm:

1. Përgatitja dhe propozimi i një periudhe kohore planifikimi për më shumë se një vit, për të konsoliduar objektivat që synohen të arrihen. Për shembull, IP mund të planifikojë një fushatë 3-vjeçare. Fushata mund të synojë të gjithë sektorët ekonomikë, ose vetëm një sektor, aty ku ky problem është më i theksuar. Megjithatë, fushata e parë e përgjithshme duhet të jetë gjithmonë gjithëpërfshirëse.
2. Objektivat mund të jenë, ndër të tjera:
 - ▶ dhënia e kontributit për reduktimin e punës së padeklaruar në përqindje brenda një periudhe 3-vjeçare (*zgjidhni disa nga treguesit e vlerësimit të riskut dhe evoluimin e tyre - para dhe pas fushatës*);
 - ▶ rritja sasiore e kontributeve të sigurimeve shoqërore;
 - ▶ ulja e numrit të ankesave në inspektoratet e punës;
 - ▶ realizimi i një numri të caktuar masash informuese dhe audience të synuar nga institucionet e ndryshme pjesëmarrëse në fushatë;
 - ▶ realizimi i një sërë inspektimeve në vendet e punës;
 - ▶ rritja e numrit të sinjalizimeve për shkelje të ndryshme (*megjithatë, në një moment të mëvonshëm, nëse evidentohet respektimi i detyrimeve ligjore për shkak të fushatës, supozohet se edhe ulja e këtij numri mund të jetë një tregues i mirë*).
 - ▶ rritja e numrit të transformimit të punëtorëve fiktiv të vetëpunësuar në punonjës vartës.
3. Marrja e miratimit të qeverisë, nëse nevojitet, duke shpjeguar objektivat strategjike, bazuar në të dhënat statistikore zyrtare, lajmet në lidhje me fenomenin në rrjetet sociale dhe në media, shqetësimet e partnerëve socialë dhe informacioni i mbledhur nga inspektorët e punës.
4. Përfshirja e partnerëve socialë për përgatitjen e fushatës, duke paraqitur një dokument të thjeshtë dhe informues në lidhje me avantazhet që do të buronin nga realizimi i saj. Për organizimin e kësaj fushate dhe të planit përkatës të veprimit duhet të krijohet një grup pune multidisiplinar me përfaqësues nga të gjithë partnerët socialë.
5. Planifikimi mund të bazohet në metodologji të ndryshme, siç është karta e balancuar e rezultateve, gjithmonë duke marrë parasysh vlerësimin e riskut të përshkruar më parë.


6. Fushata duhet të kalojë gjithmonë nëpër tri faza operacionale: faza e informimit, faza e inspektimit dhe faza e vlerësimit.
 7. Pas dakordimit të planit me partnerët socialë, duhet të ftohen për t'iu bashkuar fushatës edhe organet e tjera inspektuese: organi tatimor, struktura inspektuese e sigurimeve shoqërore, struktura inspektuese e aktiviteteve ekonomike, policitë e ndryshme - policia e huaj dhe ajo kufitare, nëse ka.
 8. Më pas duhet të ftohen partnerë të tjerë jo inspektues: universitetet, shkollat e arsimit profesional, qendrat teknologjike, shërbimet e punësimit, zyrat kombëtare të statistikave, organet rregulluese profesionale etj.
 9. Për mbikëqyrjen e fushatës duhet të caktohen dy grupe pune: (i) një grup me përfaqësues të partnerëve socialë dhe inspektoratit të punës, që mblidhet të paktën çdo dy javë - ky grup mund të ketë edhe një përfaqësues të qeverisë në përbërje të tij; (ii) një grup tjetër pune më i gjerë, me përfaqësues nga secili prej partnerëve që janë pjesë e fushatës - ky grup duhet të mblidhet çdo dy muaj.
10. Pas kësaj, fillon fushata duke ndjekur hapat e mirëpërcaktuar si më poshtë:

- ▶ *Faza e informimit* - prezantimi fillestar i fushatës në media (nëpërmjet edhe një konference prezantuese për shtyp); përdorimi i mjediseve të jashtme, i fletëpalosjeve, etj.; reklamimi në gazeta dhe revista, fizike dhe online; spote radio-televizive, etj. Faza e reklamimit dhe publicitetit do të varet shumë nga buxheti ekzistues dhe do të zgjasë gjatë gjithë fushatës; dimensionin informues do të përmbajë seminare, konferenca dhe debate, të udhëhequra nga partnerët socialë, nga strukturat e ndryshme inspektuese, bashkitë, universitetet, shkollat e përgjithshme dhe shkollat profesionale, qendrat kërkimore, organet mediatike, etj. Në këtë moment, publiku është i informuar në lidhje me objektivat e fushatës, kushtet e përmbushura që pritet të konstatohen nëpër biznese gjatë aktiviteteve inspektuese dhe metodologjitë më të mira që duhen përdorur për të vepruar në përputhje me ligjin. Kjo fazë dhe faza e informimit/propagandimit zhvillohen njëkohësisht. Megjithatë, faza e informimit nuk do të zgjasë gjatë të gjithë fushatës dhe do të përfundojë përpara fazës së inspektimit.
- ▶ *Faza e inspektimit* - kjo është periudha kur zhvillohen inspektimet, jo vetëm në vendet e punës së bashku me të gjitha organet e tjera inspektuese, por edhe takimet me punëdhënësit. Për ta detajuar më mirë, disa sektorë ekonomikë, ose të gjithë në përgjithësi, mund të inspektohen nëpërmjet vizitave të njoftuara paraprakisht, duke rritur kështu efektin frenues dhe parandalues. Ky efekt do të ishte mjaft i dobishëm për t'u arritur pasi, përveç burimeve të pakta, disa prej vendeve fizike të punës nuk mund të aksesohen me lehtësi. Kështu, paraprakisht mund të bëhet e ditur në media se në një periudhë të caktuar kohore do të kryhen inspektime në një sektor të caktuar ekonomik. Me atë rast po ashtu bëhet e ditur se këto inspektime synojnë verifikimin e respektimit të ligjit. Përpara kryerjes së inspektimit, Drejtoria e Inspektimit të Punës mund t'i ftojë edhe shoqatat e punëdhënësve dhe/ose kompanive më të rëndësishme në një sektor specifik ekonomik për tu angazhuar në një përpjekje të parë për vetërregullim.



Pas inspektimit në terren, të njëjtët aktorë të biznesit mund të ftohen sërish për një takim të dytë për një përpjekje të re për vetërregullim. Megjithatë, ky takim i dytë nuk duhet të synojë faljen e sanksioneve që janë vendosur gjatë inspektimit. Në këtë takim do të bëhet edhe një vlerësim i inspektimit, duke theksuar se do të vazhdojë. Rezultatet e inspektimit duhet që, brenda një kohe të shkurtër, të bëhen publike në media.

- ▶ *Faza e vlerësimit* - pas periudhës së inspektimit, është koha për të bërë bilancin ndërmjet rezultateve të arritura dhe objektivave të paracaktuara. Gjithmonë në këtë rast duhet të përgatitet një raport i detajuar me shkrim, me një përfundim të qartë në funksion të objektivave të përcaktuara më parë. Raporti duhet të marrë miratimin e përgjithshëm nga të gjithë partnerët e fushatës. Ky dokument duhet t'i dërgohet qeverisë dhe të prezantohet publikisht në media. Rezultatet e arritura duhet të shërbejnë si të dhëna për platformën digjitale të inspektoratit - ose për një mori bazash të dhënash - të cilat do të bëjnë të mundur përditësimin e vlerësimit të ardhshëm të riskut.



ilo.org/budapest

International Labour Organization
Central and Eastern Europe
Mozsar Utca 14
Budapest H-1066
Hungary

 facebook.com/ilocentraleasterneurope

 @ILO

 ILOTV